

# AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

## I

### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “MIKROEN SOLUTION BALKAN” sh.p.k

Mbi bazën e kërkesave të ligjit Nr. 9901 të datës 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr. 9723 të datës 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, krijohet shoqëria tregtare **“MIKROEN SOLUTION BALKAN” sh.p.k** e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

## **KREU 1**

### **THEMELIMI, EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRITARISË, KOHËZGJATJA, SELIA, VULA**

#### NENI 1


##### **DATA E THEMELIMIT, EMERTIMI I SHOQËRISË DHE THEMELUESIT**

1. Sot më datë 1 korrik 2023, në themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Mikroen Solution Balkan” sh.p.k
2. Themeluesit e shoqërisë janë :
  - Ortaku **Z. QATIP ZACI**, i lindur në Lushnje, Shqipëri më 18.04.1967 dhe banues në Kanada, në adresën: 13 Bal Harbour Dr, Grimsby Ontario Canada, shtetas Kanadez, i identifikuar me Pasaportën Nr.HN290389;
  - Ortaku **Z. THOMAS MARCO ESKI**, i lindur në Elbasan, Shqipëri më 22.04.1986, banues në Kanada, në adresën: 716 main st east unit 20, Milton Ontario Canada, L9T 3P6, shtetas Kanadez, i identifikuar me Pasaportën Nr.HN251112;
  - Ortaku **Z. GJERGJI SHORE**, lindur në Korçë, Shqipëri më 06.05.1966 banues në Korçë, në adresë: Rr. Edit Durham, Pallati PTT, Hyrja A/1, identifikuar me Kartën e Identitetit Shqiptare, Nr. G6056077B.

#### NENI 2

##### **OBJEKTI**

1. Shoqëria do të ketë Statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin fillestar.
2. Shoqëria ka për objekt aktivitetet si vijon:

G.S. T.E 

- a. Trajtimin e ujrave të ndotura përfshirë ujrat liqenore të lumenjve dhe të rezervuarve, ujrat e kripura të deteve etj., për të përfitur ujë të pijshëm.;
- b. Trajtimi i ujrave të zeza me qëllim debakterizimi për ti shkarkuar në ambjent, konform kodeve dhe ligjeve në fuqi.
- c. Trajtimi i ujrave të ndotura industriale me qëllim neutralizimi kimik dhe debakterizimi para shkarkimit në ambjent.
- d. Shitje, blerje dhe promovime pronash;
- e. Ndertimi i objekteve për banim, biznes apo aktivitet tjetër në fushën e hotelierit turizmit.
- f. Ndertimi i tubacioneve dhe kanalizimeve;
- g. Punime dhe Instalime elektrike dhe hidraulike si dhe tregtimi i tyre;
- h. Punime dhe instalime të kondicionimit të ajrit dhe të filtrimit të ujrave.
- i. Transporti rrugor, ajror dhe detar i mallrave;
- j. Punime dhe zbatime të projekteve në fushën e ndertimit;
- k. Aktivitet keshillues si dhe përgatitja e planeve përkatëse inxhinieriko/arkitekturore dhe planifikimit në fushën e ndertimit.
- l. Tregtia me shumicë dhe pakicë sipas fushave përkatëse;
- m. Aktivitet ndermjetesimi për shitjen e kimikateve industriale dhe produkteve/nenprodukteve përkatëse;
- n. Aktivitet ndermjetesimi në fushën e kontratave me hotelierit turizmin, shitblerje pasuri të paluajtshme;
- o. Bashkëpunimin me Institucione Shtetërore dhe private dhe nderkombetare me qëllim realizimin e objektit të shoqërisë.
- p. Aplikimi dhe përgatitja e praktikave përkatëse për procedurat e konkurseve dhe garave të fondeve dhe projekteve të bashkefinancuara apo grante të ofruara nga, Bashkimi Europian, Institucione shtetërore apo organizata të ndryshme nderkombetare dhe shtete të tjera.
- q. Aktivitete të tjera të specializuara në fushën e ndertimit dhe hotelierit turizmit;
- r. Promovimi i turizmit si dhe keshillimi në fushë
- s. Pajisje në fushën e ndertimit dhe eksportimi/importimi i mallrave
- t. Nxjerrja dhe tregtimi i mineraleve dhe materialeve kimike dhe plehrave kimike dhe industrial.
- u. Tregtimin me pakicë dhe me shumicë të materialeve dhe pajisjëve mjekësore dhe elektronike dhe marrjen me qira të pajisjeve.
- v. Organizimin dhe administrimin e kurseve të trajnimeve, konferencave për tu përditësuar dhe trajnime në sektorë specifikë të veprimtarisë së kompanisë.
- w. Trajnime dhe kurse nëpërmjet një akademie personale.
- x. Promovimi dhe nxitja e tij sipas fushave përkatëse nëpërmjet menyrave digjitale, dhe medias.
- y. Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale dhe financiare që janë të dobishme për të arritur qëllimin e objektit të shoqërisë.

### NENI 3

#### **KOHEZGJATJA**

1. Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat kohor të pacaktuar.

G.S.

T.E





#### NENI 4

#### **SELIA**

1. Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Rr. Hamid Shijaku, njesia administrative nr 9, vila A, 1016, Tiranë, Albania.
2. Shoqëria mund të çelë, seli të tjera të dyta, degë, përfaqësimi apo agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### NENI 5

#### **VULA**

1. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

#### **KREU II**

#### **KAPITALI**

#### NENI 6

#### **KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali fillestar i shoqërisë është 4. 000.000,00 Leke ( kater milion Leke), i cili miratohet nga te tre ortakët themelues, dhe nuk është i derdhur nga ortakët themelues dhe ndahet në 3 (tre) kuota me vlerë nominale sipas ndarjes së mëposhtme:
  - Ortaku themelues **Z. QATIP ZACI**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.200.000,00 Leke (Nje milion e dyqind mije leke), që përben 30% për qind të kapitalit të shoqërisë.
  - Ortaku themelues **Z. THOMAS MARCO ESKI**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.200.000,00 Leke (Nje milion e dyqind mije leke), që përben 30% për qind të kapitalit të shoqërisë.
  - Ortaku themelues **Z. GJERGJI SHORE**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.600.000,00 Leke (Nje milion e gjashtëqind mije leke), që përben 40% për qind të kapitalit të shoqërisë.

#### NENI 7

#### **PJESEMARRJET NE KAPITALIN THEMELTAR: ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet apo zvogelohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet

G.S. T.E  3

emërimin nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyroje një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
4. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që perfaqësojnë.
5. Pjesëmarrjet e ortakëve në kapitalin themeltar përcaktohet në raport të drejtë me kontributet e tyre në kapitalin themeltar.
6. Të drejtat, përfshirë edhe të drejtat e votës, u takojnë ortakëve në mënyrë përpjesëtimore me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin themeltar.

## NENI 8

### TRANSFERIMI I KAPITALIT

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) Kontributi në kapitalin e shoqërisë;
  - b) Shitblerjes
  - c) Trashëgimisë;
  - d) Dhurimit;
  - e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj
2. Në rast tjetërsimi të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes. Me "tjetërsim" nënkuptojmë çdo akt tjetërsimi të kuotave, në kuptimin më të gjerë të fjalës, si në pronësi të plotë ashtu dhe të pjesëshme, që, në mënyrë direkte apo indirekte, sjell ndryshimin e titullit të pronësisë mbi kuotat ose të drejtat mbi to.
3. Ortaku që synon të tjetërsojë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e tij në kapitalin themeltar duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë në Asamble ose nëpërmjet letre rekomande, ofertën e marrë, duke treguar emrin e blerësit të mundshëm dhe kushtet e tjetërsimit, në mënyrë të veçantë çmimin e përcaktuar dhe mënyrat e pagesës (këtu e me poshtë oferta).
4. Brënda njëzet ditëve nga marrja e komunikimit të Ofertës, ortakët e interesuar në ushtrimin e se drejtës së parablerjes duhet t'i komunikojnë ortakut që kalon të drejtat mbi kuotat,

G.S.

T.E





dëshirën për të ushtruar të drejtën e parablerjes, përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin themeltar dhe sipas kushteve të Ofertës, duke shprehur edhe interesin e mundshëm për blerjen e pjesës së kuotave për të cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakëve të tjerë. Është i pavlefshëm çdo komunikim që nuk përmban të gjithë të dhënat e mësipërme.

5. Në rast se ndonjë nga personat që gëzon të drejtën e parablerjes së kuotave, nuk mund ose nuk dëshiron ta ushtroje atë, e drejta e parablerjes që i takon zmadhohet automatikisht dhe përpjesëtimisht në favor të ortakëve që kanë shprehur interesin për ta ushtruar këtë të drejtë.
6. Në rast se janë disa ortakë që ushtrojnë të drejtën e parablerjes, kuotat do të shpërndahen ndërmjet tyre në përpjesëtim me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin themeltar të shoqërisë. Në rast se në letrën e komunikimit të Ofertës tregohet si blerës i mundshëm një person që është ortak, edhe atij i njihet e drejta e parablerjes, krahas ortakëve të tjerë.
7. E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet për të gjithë pjesëmarrjen e ofruar dhe për çmimin e përcaktuar, duke qenë se i tillë është objekti i propozimit të paraqitur nga ortaku ofrues.
8. Në rastin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes, nënshkrimi i kontratës së shitjes së kuotave dhe pagesa përkatëse duhet të kryhen brenda afateve të përcaktuara në propozimin e shitjes së formuluar nga ortaku ofrues.
9. Nëse e drejta e parablerjes nuk ushtrohet brenda afateve të mësipërme dhe për tërësinë e pjesëmarrjes së ofruar, ortaku ofrues mund t'i transferojë kuotat e veta në favor të blerësit të treguar në komunikimin e Ofertës dhe në kushtet e parashikuara në të, brenda gjashtëdhjetë ditëve të ardhshme. Në të kundërt procedura e parablerjes duhet të përsëritet.
10. Në rast tjetërsimi të kuotave në favor të të tretëve, pa zbatuar dispozitat e parashikuara me sipër, blerësi nuk do të legjitimohet në ushtrimin e të drejtave administrative dhe pasurore dhe tjetërsimi i kuotave nga ana e tij nuk do të prodhojë efekte ndaj shoqërisë.
11. Nëse asnjëri prej ortakëve nuk e ushtron të drejtën e parablerjes në mënyrat e përcaktuara, ortaku ofrues mund të nënshkruajë aktin e shitjes së pjesës së tij në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
12. E drejta e parablerjes nuk është domosdoshmërisht e nevojshme të ushtrohet prej ortakëve, në rast transferimi tek familjarët, të kuotave ose të pjesëve të kuotave të zotëruara prej tyre. Me specifikisht bien dakord se grada e kushërinjëvë, do të jetë deri në gradën e dytë.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

##### NENI 9

G.S.

T.E





## ORGANI VENDIMMARRËS

1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modeleve të përcaktuara në ligj.
3. Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për ceshtjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratoreve;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c dhe ç” të kësaj pike
  - e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) ka te drejte te vendose nëse administrimi i shoqërisë do te behet nga një administrator i vetëm apo nga Këshilli Administrativ i përberë nga minimumi 3(tre) dhe maksimumi 5 (pese) administratorë.
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### NENI 10

#### **MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.
2. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

G.S.

T.E





3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## NENI 11

### **KUORUMI**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 70% për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## NENI 12

### **MARRJA E VENDIMEVE**

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
3. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

## NENI 13

G. S.

T.E  7



## PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### NENI 14

#### ADMINISTRIMI

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Administratori i shoqërisë do të jete Ortaku i saj **Z. GJERGJI SHORE**, lindur në Korçë, Shqipëri më 06.05.1966 banues në Korçë, Rr. Edit Durham, Pallati PTT, Hyrja A/1, identifikuar me Kartën e Identitetit Shqiptare, Nr. G6056077B, i cili do të qendroje ne detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

### NENI 15

#### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT/ ËVE

1. Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

G.S.

T.E 



- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
    - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
    - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
    - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
  4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
  5. Në rastin e dorëheqjes së një administratori, brenda 30 (tridhjetë) ditëve duhet të thirret Asambleja e Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, në rast se ky vendim nuk merret në të njëjtën mbledhje Asambleje kur është vendosur largimi i administratorit.
  6. Në rastin e Këshillit Administrativ, administratorët mund të veprojnë bashkë asë veç e veç. Në çdo rast, nëse ekzistojnë kundërshtime ndërmjet administratorëve këta i drejtohen Asamblesë së ortakëve, e cila dhe mund të zëvendësojë Këshillin e Administrimit e të emërojë administratorë të tjerë. Administratori ose Këshilli Administrativ mund të shkarkohen në çdo moment me vendim të Asamblesë së Ortakëve me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit të shoqërisë, pa detyrim motivimi. Megjithatë nëse shkarkimi është bërë pa arsye të drejte, administratori mund të kërkojë dëmshpërblim financiar.


## ENI 16

### PËRGJEGJESITË E ADMINISTRATORIT

1. Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që ligji, statuti, akti i themelimit i rezervojnë Asamblesë së Ortakëve.
2. Administratori gëzon të drejta të kufizuara në lidhje me administrimin e llogarive rrjedhese të shoqërisë, vetëm ortakët e shoqërisë kanë të drejtën për kryerjen e çdo veprimi dhe /ose operacioni që e vlerësojnë të dobishëm për realizimin e objektivit të shoqërisë.

G.S.

T.E





3. Administratori drejton veprimtarinë e shoqërisë dhe ka te drejte qe ta përfaqësoje atë ne marrëdhëniet me te tretet
4. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
5. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
6. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

G.S.

T.E





- e) jep kredi.
7. Përveç asaj çka parashikohet nga ligji, Administratori ka detyrën e kryerjes se veprimeve te mëposhtme:
- a) përgatit dhe harton inventarin, te llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, raportin e ecurisë se veprimtarisë se shoqërisë, ne mbyllje te çdo viti financiar dhe se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ja dërgon Asamblesë se Ortakeve për miratim;
  - b) hartimin e projekteve te bashkimit ose te ndarjes se shoqërisë;
  - c) te informoje asamblenë mbi zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e operacioneve tregtare me rendësi për shoqërinë;
  - d) te raportojë përpara Asamblesë se Ortakeve mbi faktet qe mund te kenë pasoja negative mbi ecurinë apo ekzistencën e shoqërisë;
  - e) Administratorët mund te delegojnë përfaqësues te posaçëm për kryerjen e akteve te veçanta ose te një kategori aktesh, duke përcaktuar kompetencat përkatëse;
  - f) te thërrasë Asamblenë e Ortakeve ne rastet e parashikuara me ligj;
- Si dhe çdo te drejte tjetër e cila është përcaktuar me ligj për arritjen e qëllimit te shoqërisë
8. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
9. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## NENI 17

### **PERFAQESIMI I ADMINISTRATORIT**

1. Administratori ka te drejtën e përfaqësimit te shoqërisë kundrejt te tretëve dhe ne gjykim. Ai mund te caktojë avokate dhe përfaqësues te shoqërisë përpara organeve gjyqësore, organeve te administratës shtetërore dhe te tretëve, si dhe përfaqësues te posaçëm për akte te veçanta apo kategori aktesh.
2. E drejta e firmës se shoqërisë mund te ushtrohet edhe nga personat te cilëve u është deleguar kjo e drejte brenda kufijve te kompetencave te dhëna.

G.S.

T.E



3. Administratori ka te drejtën e rimbursimit te shpenzimeve te bëra gjate ushtrimit te funksioneve si dhe një shpërblim vjetor te përcaktuar nga asambleja e ortakeve ne momentin e emërimit ose me vendim te posaçëm.

#### NENI 18

#### MARRËDHËNIET E PUNES

1. Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratave te punës dhe konform Kodit te Punës se Republikës se Shqipërisë.

#### KREU IV

#### VITI FINANCIAR-EKSPERTET

#### NENI 19

#### VITI FINANCIAR

1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.
2. Ne fund te çdo periudhe te ushtrimit te aktivitetit hartohet bilanci kontabël, brenda afateve dhe konform ligjeve ne fuqi.
3. Dokumentet e kontabilitetit, te shoqëruar nëse e nevojshme nga relacioni i ekspertit kontabël te autorizuar, duhet t'u komunikohen ortakeve dhe te vihen ne dispozicionin e tyre pranë selisë se shoqërisë, te paktën 15 dite përpara datës se mbledhjes se asamblesë.
4. Shoqëria ka llogarinë rrjedhëse te saj si dhe librat kontabël ne përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe dispozitave te tjera fiskale ne Republikën e Shqipërisë
5. Transferimi i vlerave monetare dhe transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kritereve te përcaktuara nga Banka e Shqipërisë.

G.S.

T.E





## NENI 20

### **FITIMET**

1. Fitimet qe rezultojnë nga bilanci ushtrimor do te shpërndahen ndërmjet ortakeve pasi te jene zbritur nga kjo shume vlere e humbjeve te pësuar gjate vitit ushtrimor paraardhës si dhe 5%(pese për qind) qe destinohet për fondet e rezervës se domosdoshme, derisa kjo te ketë arritur kufirin e parashikuar me ligj.
2. Pjesa qe mbetet pas zbritjes se zërave te mësipërm, do tu shpërndahet pronareve te kuotave te kapitalit themeltar përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e tyre, ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, me përjashtim te destinimit te ndryshëm te vendosur nga vete ortaket.

## NENI 21

### **FINANCIMI I ORTAKEVE**

1. Shoqëria mund te marre nga ortaket financime me ose pa shpërblim, ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Dhënia e këtyre financimeve nga ana e ortakeve është e lire.

## **KREU V**

### **PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

## NENI 22

### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :
  - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) veprimtaria e shoqërisë është negative;
  - c) veprimtaria e shoqërisë është e pamundur;
  - d) riorganizohet ne një forme tjetër
    - a) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
    - b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
    - c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
    - d) me çdo rast tjetër te parashikuar nga ligji, si dhe;
    - e) me vendim të gjykatës;

G.S.

T.E



2. Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.
3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
5. Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **NENI 23**

### **RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA**

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

### **NENI 24**

### **EKSPERTET**

1. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërise, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.
2. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

### **NENI 25**

### **BAZA LIGJORE**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

G.S.

T.E





2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

## NENI 26

### **MOSMARRËVESHJET**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### ***ORTAKET***

#### ***E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR*** **"MIKROEN SOLUTION BALKAN" sh.p.k**

**Z. QATIP ZACI**

( QATIP ZACI )



**Z. THOMAS MARCO ESKI**

( Thomas Eski )



**Z. GJERGJI SHORE**

( GJERGJI SHORE )



**ADMINISTRATORI**

**Z. GJERGJI SHORE**

( GJERGJI SHORE )



Tirane me .....